



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.142

16 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1222, datë 3.9.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Bulqizë-Ura Çerenecit.....	6307
Vendim i KMBSH nr.59, datë 29.8.2008	Për miratimin e rregullores “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.....	6317
Vendim i KMBSH nr.60, datë 29.8.2008	Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.....	6328
Vendim i KMBSH nr.61, datë 29.8.2008	Për disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë”	6341
Vendim i KMBSH nr.62, datë 29.8.2008	Për disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja”.....	6343
Vendim i ERE nr.100, datë 26.8.2008	Për miratimin e kodit të shpërndarjes së energjisë elektrike	6343
Vendim i ERE nr.101, datë 26.8.2008	Për miratimin e kodit të matjes së energjisë elektrike.....	6344
Vendim i ERE nr.103, datë 4.9. 2008	Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike	6344
Vendim i ERE nr.104, datë 4.9.2008	Për fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit	6345

Vendim i ERE nr.105, datë 4.9.2008	Për një devijim nga rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s në lidhje me procesin e rishikimit të rregullores për procedurat e licencimit	6345
Vendim i ERE nr.106, datë 4.9.2008	Për fillimin e procedurave për miratimin e “Kontratës për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (Furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (Furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.7.2008 deri më 31.12.2008.....	6345
Vendim i ERE nr.108, datë 9.9.2008	Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, ndryshimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave	6347
	Ndreqje gabimi.....	6347

VENDIM
Nr.1222, datë 3.9.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR BULQIZË-URA ÇERENECIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.12.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Bulqizë-Ura Çerenecit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 39 260 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) m², tokë arë, të vlerësuar me 7 067 992 (shtatë milionë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, për sipërfaqe 108 (njëqind e tetë) m², tokë truall, me një vlerë shpronësimi 47 196 (dyzet e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 1 645 000 (një milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 115 188 (shtatë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti shtesë i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të fillojë më 15.9.2008 dhe të përfundojë më 30.11.2008.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
 8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të verifikojë përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrat e pasurive, në pronësi të pronarëve, që shpronësohen.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHNEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

BULQIZE - BLLATE - URA E ÇERENECIT

Qarku Diber , Komuna ZERQAN, Fshati GODVI

NR.	EMERI	ATESIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASUR.	LLOJII PASURISE						TOTALI	SHENIME
						Are			Truall				
						M 2	Çmimi	VL_(Leke)	M2	Çmimi	VL_(Leke)	Leke	
1	SKENDER	TAHIR	FIKU	1824	97/4	280	197	55160	0		0	55160	Plot. Dok.
2	ILMI	TAHIR	FIKU	1824	97/6	290	197	57130	0		0	57130	Plot. Dok.
3	MUHARREM	HAMIT	FIKU	1824	213/1	320	197	63040	0		0	63040	Plot. Dok.
4	IBRAHIM	HAMIT	FIKU	1824	213/2	504	197	99288	0		0	99288	Plot. Dok.
5	AQIF	SHABAN	FIKU	1824	29/5	400	197	78800	0		0	78800	Plot. Dok.
6	ISMAIL	AQIF	FIKU	1824	29/4	120	197	23640	0		0	23640	Plot. Dok.
	SHUMA					1914		377058			0	377058	

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

BULQIZE - BLLATE - URA E ÇERENECIT

Qarku Diber , Komuna ZERQAN, Fshati VALIKARDHE

NR.	EMERI	ATESIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASUR.	LLOJII PASURISE						TOTALI		SHENIME
						Are			Truall			Leke		
						M 2	Çmimi	VL.(Leke)	M2	Çmimi	VL.(Leke)			
1	LIME		ALLUSHI	3706	308/5	244	218	53192	0		0	53192	Plot. Dok.	
2	SHEFQET	OSMAN	ZENELI	3706	308/4	704	218	153472	0		0	153472	Plot. Dok.	
3	OSMAN	SELIM	ZENELI	3706	308/2	273	218	59514	0		0	59514	Plot. Dok.	
4	IDRIZ	OSMAN	ZENELI	3706	308/1	620	218	135160	0		0	135160	Plot. Dok.	
5	BAJRAM	HAMET	HYKA	3706	309/10	1200	218	261600	0		0	261600	Plot. Dok.	
6	LAHIM	MUSTAFA	ZOGU	3706	309/14	650	218	141700	0		0	141700	Plot. Dok.	
7	IDRIZ	OSMAN	ZENELI	3706	308/3	357	218	77826			0	77826	Plot. Dok.	
8	BUJAR	MUSTAFA	ZOGU	3706	309/13	463	218	100934	0		0	100934	Plot. Dok.	
9	B.Pr.Ylli Rakip Hoxha	Gezim Hasan Hoxha		3706	296/2	426	218	92868	0		0	92868	Plot. Dok.	
	SHUMA					4937		1076266			0	1076266		

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

BULQIZE - BLLATE - URA E QERENECIT

Qarku Diber , Komuna ZERQAN, Fshati KRAJKE

NR.	EMERI	ATESIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASUR.	LLOJI I PASURISE						TOTALI		SHENIME
						Are				Truali		Leke	VL_(Leke)	
						M 2	Çmimi	VL_(Leke)	M2	Çmimi				
1	ALI		NERA	2262	9811	52	246	12792			0	12792	Plot. Dok.	
2	ALI	FERIT	NELA	2262	9912	135	246	33210			0	33210	Plot. Dok.	
3	XHELADIN	BAJRAM	NERA	2262	10018	208	246	51168			0	51168	Plot. Dok.	
4	ALI	TAL	NERA	2262	10019	115	246	28290			0	28290	Plot. Dok.	
5	ISMAIL	FERIT	KURCANI	2262	10014	117	246	28782			0	28782	Plot. Dok.	
6	XHEZMI	ASLLAN	NERA	2262	11414	735	246	180810			0	180810	Plot. Dok.	
7	DILAVER	ALI	HOXHA	2262	11112	450	246	110700			0	110700	Plot. Dok.	
8	XHELADIN	JAHO	NERA	2262	2911	30	246	7380			0	7380	Plot. Dok.	
9	SKENDER	TAL	NERA	2262	2912	45	246	11070			0	11070	Plot. Dok.	
10	DASHAMIR	ALI	NERA	2262	10911	125	246	30750			0	30750	Plot. Dok.	
11	SABRI	DILAVER	NERA	2262	10912	312	246	76752			0	76752	Plot. Dok.	
12	DEFRIM	SELIM	NERA	2262	2919	885	246	217710			0	217710	Plot. Dok.	
13	BAJRAM	HYSEN	NERA	2262	29110	728	246	179088			0	179088	Plot. Dok.	
14	BESHIR	DILAVER	DERVISHI	2262	3811	1875	246	461250			0	461250	Plot. Dok.	
15	BAJRAM	DAN	NERA	2262	2918	292	246	71832			0	71832	Plot. Dok.	
16	DEFRIM	DILAVER	NERA	2262	2917	285	246	70110			0	70110	Plot. Dok.	
17	SABRI	HYSEN	NERA	2262	2914	255	246	62730			0	62730	Plot. Dok.	
18	AGIM	SELIM	KURCANI	2262	11111	687	246	169002			0	169002	Plot. Dok.	
19	MUHAREM	MUHAREM	NERA	2262	11213	100	246	24600			0	24600	Plot. Dok.	
20	SKENDER	ALI	NERA	2262	11212	135	246	33210			0	33210	Plot. Dok.	
21	MITE	ALI	NERA	2262	11211	185	246	45510			0	45510	Plot. Dok.	
22	LUTFI	SADIK	KURCANI	2262	12619	85	246	20910			0	20910	Plot. Dok.	
23	MUHAREM	SHABAN	NERA	2262	12617	18	246	4428			0	4428	Plot. Dok.	
24	ILIR	ALI	LAMI	2262	115117	132	246	32472			0	32472	Plot. Dok.	
25	LUTFIE	RAMADAN	CANI	2262	115115	176	246	43296			0	43296	Plot. Dok.	
26	SKENDER	RIFAT	NERA	2262	115114	126	246	30996			0	30996	Plot. Dok.	
27	FERIDE	ALI	BEKA	2262	115116	108	246	26568			0	26568	Plot. Dok.	

28	PETRIT	XHEMAL	KURCANI	2262	115/4	80	246	19680			0	19680	Plot. Dok.
29	LUTFI	SHABAN	KURCANI	2262	115/3	85	246	20910			0	20910	Plot. Dok.
30	ABAZ	SHABAN	BEKA	2262	115/8	180	246	44280				44280	
31	MOIZ	HAJREDIN	BEKA	2262	115/7	120	246	29520				29520	
32	ISMAIL	ASLLAN	KURCANI	2262	100/15	52	246	12792				12792	
	SHUMA					8913		2192598				2192598	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
M. P. P, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHESHME E RRUGEVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONESIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

BULQIZE - BILLATE - URA E ÇERENECIT

Qarku Diber, Bashkia Bulqize, Fshati VAJKAL

NR.	EMERI	ATESIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASUR.	LLOJII PASURISE						TOTALI		SHENIME
						Are			Truall			Leke		
						M 2	Çmimi	VL_(Leke)	M2	Çmimi	VL_(Leke)			
1	LIMAN	MEXHIT	VOCI	3694	752/3	156	197	30732	0		0	30732	Plot. Dok.	
2	HAKI	ISUF	DAUTI	3694	755/1	360	197	70920	0		0	70920	Plot. Dok.	
3	SADIK	ALI	SADIKU	3694	767/1	200	197	39400	0		0	39400	Plot. Dok.	
4	AFRIM	HID	SULA	3694	767/3	138	197	27186	0		0	27186	Plot. Dok.	
5	HALIT	BILAL	SULA	3694	767/7	90	197	17730	0		0	17730	Plot. Dok.	
6	HAJRIE	ISUF	SULA	3694	767/10	90	197	17730	0		0	17730	Plot. Dok.	
7	FAIK	HYSEN	TANÇI	3694	770	50	197	9850	0		0	9850	Plot. Dok.	
8	NIMETALIE	HYSEN	TANÇI	3694	775	50	197	9850	0		0	9850	Plot. Dok.	
9	ISMET	HYSEN	TANÇI	3694	776	50	197	9850	0		0	9850	Plot. Dok.	
10	KUJTUM	HYSEN	TANÇI	3694	781	50	197	9850	0		0	9850	Plot. Dok.	
11	HAJDAR	HYSEN	TANÇI	3694	782	50	197	9850	0		0	9850	Plot. Dok.	
12	RIFAT	BAJRAM	TANÇI	3694	786	100	197	19700	0		0	19700	Plot. Dok.	
13	ILMI	BAJRAM	TANÇI	3694	789	100	197	19700	0		0	19700	Plot. Dok.	
14	DALIP	BAJRAM	TANÇI	3694	791	125	197	24625	0		0	24625	Plot. Dok.	
15	SHEFQET	ELMAZ	TANÇI	3694	1463/2	90	197	17730	0		0	17730	Plot. Dok.	
16	MITE	BAJAZIT	KOLA	3694	1462/2	72	197	14184	0		0	14184	Plot. Dok.	
17	MOIZ	KAMBER	TANÇI	3694	1462/1	90	197	17730	0		0	17730	Plot. Dok.	
18	AFRIM	HID	SULA	3694	1503	506	197	99682	0		0	99682	Plot. Dok.	
19	ALFRED	BESNIK	TANÇI	3694	1464/5	56	197	11032	0		0	11032	Plot. Dok.	

20	ALFRED	BESNIK	TANÇI	3694	1467/1	48	197	9456	0	0	9456	Plot. Dok.
21	HYSEN	JONUZ	CENI	3694	1469/1	72	197	14184	0	0	14184	Plot. Dok.
22	SULEJMAN	QAZIM	ALIAJ	3694	1469/2	88	197	17336	0	0	17336	Plot. Dok.
23	BEDRI	HALIT	ALIAJ	3694	1472/1	32	197	6304	0	0	6304	Plot. Dok.
24	FATMIR	HALIT	ALIAJ	3694	1472/2	32	197	6304	0	0	6304	Plot. Dok.
25	KAPLAN	HAMIT	ALIAJ	3694	1472/3	32	197	6304	0	0	6304	Plot. Dok.
26	ROLAND	DESTAN	ALIAJ	3694	1472/4	32	197	6304	0	0	6304	Plot. Dok.
27	QAMIL	MUSTAFA	SULA	3694	1473	64	197	12608	0	0	12608	Plot. Dok.
28	XHEMILE	HYSEN	SULA	3694	1476/1	60	197	11820	0	0	11820	Plot. Dok.
29	SAHADE	ADEM	HOXHA	3694	1476/2	70	197	13790	0	0	13790	Plot. Dok.
30	SADIE	FASLI	SADIKU	3694	764	100	197	19700	0	0	19700	Plot. Dok.
31	AFRIM	HID	SULA	3694	763	30	197	5910	0	0	5910	Plot. Dok.
32	ALFRED	BESNIK	TANÇI	3694	1464/3	96	197	18912	0	0	18912	Plot. Dok.
33	DIAMANT	SADIK	HOXHA	3694	1482/2	36	197	7092	0	0	7092	Plot. Dok.
34	ZAIDE	SELMAN	BALLA	3694	909	200	197	39400	0	0	39400	Plot. Dok.
35	ISMAIL	RIZA	BALLA	3694	910	388	197	76436	0	0	76436	Plot. Dok.
36	HYSNI	HYSEN	BALLA	3694	912	667	197	131399	0	0	131399	Plot. Dok.
37	HYSNI	HYSEN	BALLA	3694	913	660	197	130020	0	0	130020	Plot. Dok.
38	TUSHE	MUSTAFA	LIKA	3694	915	589	197	116033	0	0	116033	Plot. Dok.
39	TUSHE	MUSTAFA	LIKA	3694	1057	216	197	42552	0	0	42552	Plot. Dok.
40	KUJTIM	FADIL	TERNOVA	3694	1059	112	197	22064	0	0	22064	Plot. Dok.
41	TUSHE	MUSTAFA	LIKA	3694	1426	220	197	43340	0	0	43340	Plot. Dok.
42	KUJTIM	FADIL	TERNOVA	3694	1425/1	561	197	110517	0	0	110517	Plot. Dok.
	SHUMA					6828		1345116		0	1345116	

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHNEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
BULQIZE - BLLATE - URA E ÇERENECIT

Qarku Diber , Komuna FUSHE-BULQIZE, Fshati FUSHE-BULQIZE

NR.	EMERI	ATESIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASUR.	LLOJI I PASURISE						TOTALI	SHENIME
						Are			Truall				
						M 2	Çmimi	VL_(Leke)	M2	Çmimi	VL_(Leke)		
1	MUHAREM	HAMIT	ZENELI	1660	11	495	122	60390	0		0	60390	Plot. Dok.
2	GEZIM	LAHIM	ZENELI	1660	10	320	122	39040	0		0	39040	Plot. Dok.
3	SHKELQIM	ABDULLA	GJINI	1660	131	130	122	15860	0		0	15860	Plot. Dok.
4	HASAN	JONUZ	KICA	1660	128	70	122	8540	0		0	8540	Plot. Dok.
5	RIZA	HAJREDIN	KICA	1660	127	300	122	36600	0		0	36600	Plot. Dok.
6	HASAN	JONUZ	KICA	1660	125	383	122	46726	0		0	46726	Plot. Dok.
7	RIFAT	SEIT	KOLA	1660	124	210	122	25620	0		0	25620	Plot. Dok.
8	AGRON	TAHIR	KICA	1660	47	256	122	31232	0		0	31232	Plot. Dok.
9	HAMZA	SULEJMAN	KICA	1660	68	40	122	4880	0		0	4880	Plot. Dok.
10	RABIE	HYSEN	KICA	1660	72	54	122	6588	0		0	6588	Plot. Dok.
11	BILAL	SHAHIN	KOLA	1660	123	75	122	9150	0		0	9150	Plot. Dok.
12	SHPETIM	HASAN	KOLA	1660	114	300	122	36600	0		0	36600	Plot. Dok.
13	SEIT	SHAHIN	KOLA	1660	108	192	122	23424	0		0	23424	Plot. Dok.
14	RIZA	HAJREDIN	KICA	1660	83	231	122	28182	0		0	28182	Plot. Dok.
15	SADETE	DILE	GJINI	1660	89	72	122	8784	0		0	8784	Plot. Dok.
16	ARBEN	ISUF	KOLA	1660	90	120	122	14640	108	437	47196	61836	Plot. Dok.
17	RAMADAN	HYSEN	DEDJA	1660	603	1150	122	140300	0		0	140300	Plot. Dok.
18	REXHEP	BAJRAM	DOGA	1660	669/2	420	122	51240	0		0	51240	Plot. Dok.
19	VELI	IZET	DOGA	1660	669/1	195	122	23790	0		0	23790	Plot. Dok.
20	RIZA	HYSEN	XHAFA	1660	971/2	108	122	13176	0		0	13176	Plot. Dok.
21	RAKIP	HYSEN	XHAFA	1660	971/1	108	122	13176	0		0	13176	Plot. Dok.
22	HYSEN	ALI	BALJA	1660	935	300	122	36600	0		0	36600	Plot. Dok.
23	SADETE	DILE	GJINI	1660	200	276	122	33672	0		0	33672	Plot. Dok.
24	PETRIT	RAMADAN	XHAFA	1660	981	132	122	16104	0		0	16104	Plot. Dok.
25	PETRIT	RAMADAN	XHAFA	1660	980	900	122	109800	0		0	109800	Plot. Dok.
26	MERJEME	MUHAREM	BALJA	1660	737	255	122	31110	0		0	31110	Plot. Dok.

27	HYSEN	ALI	BALJA	1660	935	300	122	36600	0		0	36600	Plot. Dok.
28	HYSEN	ALI	BALJA	1660	936	300	122	36600	0		0	36600	Plot. Dok.
29	ABDULLA	ADEM	XHAFA	1660	747	80	122	9760	0		0	9760	Plot. Dok.
30	BESIM	HAMIT	GJURA	1660	754	256	122	31232	0		0	31232	Plot. Dok.
31	FIQIRI	BILAL	GJURA	1660	755	160	122	19520	0		0	19520	Plot. Dok.
32	KUJTIM	MALIQ	KUKA	1660	761	994	122	121268	0		0	121268	Plot. Dok.
33	MUSTAFA	MALIQ	KUKA	1660	764	1178	122	143716	0		0	143716	Plot. Dok.
34	MUHAREM	MALIQ	KUKA	1660	766	524	122	76128	0		0	76128	Plot. Dok.
35	SHEFQET	HASAN	DAKA	1660	921	1452	122	177144	0		0	177144	Plot. Dok.
36	LATIF	SULEJMAN	DODA	1660	795	60	122	7320	0		0	7320	Plot. Dok.
37	SELMAN	TAHIR	DODA	1660	793	480	122	58560	0		0	58560	Plot. Dok.
38	MEHMET	HYSEN	XHAFA	1660	791	400	122	48800	0		0	48800	Plot. Dok.
39	RIZA	HYSEN	XHAFA	1660	790	192	122	23424	0		0	23424	Plot. Dok.
40	ARTUR	FIQIRI	GJURA	1660	759	144	122	17568	0		0	17568	Plot. Dok.
41	PETRIT	RAMADAN	XHAFA	1660	992	493	122	60146	0		0	60146	Plot. Dok.
42	SELMAN	JONUZ	PERKOLA	1660	639	1570	122	191540	0		0	191540	Plot. Dok.
43	ALBERT	SADIK	DAKA	1660	959	160	122	19520	0		0	19520	Plot. Dok.
44	QAMIL	ABDULLA	XHAFA	1660	745	110	122	13420	0		0	13420	Plot. Dok.
	SHUMA					16045		1957490	108	437	47196	2004686	

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHNEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

BULQIZE - BLLATE - URA E ÇERENECIT

Qarku Diber , Komuna FUSHE-BULQIZE, Fshati DRAGU

NR.	EMERI	ATESIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASUR.	LLOJII PASURISE						TOTALI	SHENIME
						Are			Truall				
						M 2	Çmimi	VL.(Leke)	M2	Çmimi	VL.(Leke)		
1	PELLUMB	MEHMET	BOBA	1532	529	84	116	9744	0		0	9744	Plot. Dok.
2	PELLUMB	MEHMET	BOBA	1532	528	144	116	16704	0		0	16704	Plot. Dok.
3	BAJRAM	ISUF	BOBA	1532	255/1	130	116	15080	0		0	15080	Plot. Dok.
4	ISUF	MEHMET	BOBA	1532	255/2	240	116	27840	0		0	27840	Plot. Dok.
5	HALIT	SULEJMAN	BOBA	1532	226/1	25	116	2900	0		0	2900	Plot. Dok.
	SHUMA					623		72268			0	72268	

VENDIM
Nr.59, datë 29.8.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E
FINANCIARE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të nenit 53 pika 4 të shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 55, të nenit 56 pika 2, neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet udhëzimi “Mbi transparencën e operacioneve dhe shërbimeve bankare”, i miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.49, datë 22.4.1999 dhe neni 22/1 i rregullore “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.52, datë 14.7.2004.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE
(Miratuar me vendimin nr. 59.datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbi mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit për klientët mbi produktet dhe shërbimet bankare e financiare të ofruara nga subjektet e kësaj rregulloreje, me qëllim sigurimin e transparencës dhe mbrojtjen e klientit.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet financiare jobanka (më poshtë për thjeshtësi do t’i referohemi me termin “banka”), të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji “Për bankën”) dhe të nenit 53 pika 4, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 55, të nenit 56 pika 2, të neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë ligji “Për bankat”).

Neni 4 **Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4 të ligjit “Për bankat”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Normë efektive e interesit” (NEI) - është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje;

b) “Kostoja totale e kredisë për klientin” është tërësia e të gjitha shpenzimeve, duke përfshirë dhe interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që klienti paguan në lidhje me marrëveshjen e kredisë sipas kushteve të saj (shpenzimet për shërbimet ndihmëse për marrëveshjen e kredisë, në veçanti primet e sigurimit, përfshihen nëse shërbimi është i detyrueshëm për të përfutur kredinë ose normën e interesit të aplikuar).

KREU II PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE

Neni 5 **Kërkesa të përgjithshme**

1. Bankat publikojnë:

a) afatet dhe kushtet e llogaritjes dhe të ndryshimit të normave të interesit për depozitat, për kreditë dhe komisionet për shërbimet e kryera;

b) metodologjinë e llogaritjes së interesave për depozitat dhe kreditë; si dhe

c) kushtet dhe afatet e shlyerjes së kredive.

Publikimi i tyre bëhet edhe në faqen e bankave në internet.

2. Bankat sigurojnë që informacioni, afatet, kushtet e produkteve dhe shërbimeve, të drejtat dhe përgjegjësitë e klientit, të jenë të plota dhe të sakta, si dhe në një gjuhë të kuptueshme për klientin. Gjuha ligjore ose teknike, do të përdoret vetëm kur paraqitet e domosdoshme.

3. Përpara se klienti të zgjedhë një produkt ose shërbim, bankat i japin klientit paraprakisht informacion të plotë për kushtet, afatet dhe normat në përqindje të interesit, për rreziqet që shoqërojnë marrjen e produktit apo shërbimit, si dhe komisionet dhe gjobat (penalitetet), në rastet kur këto të fundit bëhen të aplikueshme etj.

4. Në rastet kur bankat ndryshojnë kushtet e kontratave dhe/ose të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare apo financiare, ato duhet të njoftojnë me shkrim dhe në mënyrë individuale, secilin klient që është subjekt i këtyre ndryshimeve. Ky njoftim, duhet të kryhet përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme. Ai duhet të përmbajë informacion të saktë, të plotë dhe të shprehur në një gjuhë të kuptueshme për klientin.

5. Përveç sa përcaktohet në pikën 4, bankat informojnë klientin/ët për ndryshimin e kushteve të kontratave dhe/ose të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare apo financiare, duke përdorur si mjet njoftimi një nga format vijuese: me shkrim, me mjetet elektronike të komunikimit, me afishimin e njoftimeve ose broshurave në ambientet e bankës, me mjetet e komunikimit masiv.

6. Bankat informojnë paraprakisht klientin, në rastin e përdorimit të kartave të debitit/cash dhe të kartave të kreditit, për kushtet e përdorimit dhe për komisionet e veprimeve që kryhen me kartë, në veçanti në ATM-të e bankës dhe ATM-të e bankave të tjera. Ky informacion afishohet për klientin pranë ATM-së, përveçse informimit në marrëveshjen (kontratën) e lidhur për këtë lloj shërbimi. Përmbajtja e njoftimit që do të vendoset pranë çdo ATM-je të bankës do të jetë sipas aneksis nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

7. Bankat u bëjnë të qartë klientëve të gjitha rreziqet e mundshme me të cilat mund të

përballen në përdorimin e çdo produkti apo shërbimi që ato ofrojnë.

Neni 6

Metoda e llogaritjes dhe publikimi i normës efektive të interesit për kreditë

1. Norma efektive e interesit llogaritet sipas formulës matematike të paraqitur në aneksin nr.1 të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllime të llogaritjes së normës efektive të interesit, totali i kostos së kredisë për klientin sipas nenit 4, pika b, nuk përfshin:

a) shpenzimet që nuk njihen në datën e llogaritjes, që mund të ndodhin gjatë disbursimit të kredisë;

b) shpenzimet e pagueshme nga klienti për moszbatimin e ndonjë prej angazhimeve të tij, të parashikuara në marrëveshjen e kredisë;

c) shpenzimet e tjera të ndryshme nga çmimi i blerjes, të cilat, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, klienti është i detyruar t'i paguajë nëse blerja është kryer me para në dorë ose me kredi me këste, me kusht që vetë banka të mos jetë përfituesi i fundit i këtyre pagesave;

d) kostot e pagueshme nga klienti, lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, një noter, autoriteti i taksave, regjistri i hipotekave) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë;

e) shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë jo të detyrueshme;

f) çdo shpenzim që do t'i paguhet bankës nga klienti vetëm kur:

v) kredia në dispozicion nuk është përdorur në tërësi ose pjesërisht;

vi) klienti kërkon një ndryshim të afateve të pagesave dhe banka e pranon një kërkesë të tillë.

3. Shpenzimet e mbajtjes së një llogarie apo të përdorimit të një karte ose mjeti tjetër pagese për transaksionet e livrimit të kredisë dhe pagesës, si dhe kosto të tjera lidhur me transaksionet e pagesave në përgjithësi, do të përfshihen në koston totale të kredisë për klientin, nëse janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të veçantë në marrëveshjen e kredisë ose në ndonjë marrëveshje tjetër, të përfunduar me klientin.

4. Norma efektive e interesit llogaritet bazuar në supozimin që marrëveshja (kontrata) e kredisë është e vlefshme për periudhën e rënë dakord dhe palët plotësojnë detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në marrëveshjen (kontratën) e kredisë.

5. Në rastin e marrëveshjeve të kredisë që përmbajnë dispozita, që lejojnë ndryshime në normat e interesit ose shpenzimet e tjera që përfshihen në normën efektive të interesit, por të pamatshme në kohën kur kjo normë llogaritet, norma efektive e interesit llogaritet duke supozuar që përqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara (fikse), në lidhje me nivelin fillestar dhe do të mbeten të aplikueshme deri në fund të marrëveshjes së kredisë.

6. Banka duhet të parashikojë në kontratën e kredisë mënyrën e njoftimit të klientit në çdo rast të ndryshimit të elementeve bazë në llogaritjen e normave efektive të interesit, përpara se të zbatojë këtë ndryshim.

7. Norma efektive e interesit publikohet duke përdorur termin “norma efektive e interesit” ose shkurtimin “NEI”.

8. Banka publikon normën efektive të interesit në mënyrë të saktë dhe të thjeshtë në ambientet e bankës.

9. Banka paraqet pranë Bankës së Shqipërisë raporte në baza tremujore mbi normat efektive të interesit, për të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve që ajo i ofron klientëve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas përfundimit të periudhës tremujore.

10. Banka e Shqipërisë mund të publikojë të dhënat mbi normat efektive të interesit, të raportuara nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 7

Elemente të marrëveshjes (kontratës) së kredisë

1. Për çdo marrëdhënie kreditimi, banka dhe kredimarrësi nënshkruajnë një marrëveshje

(kontratë) me shkrim, e cila minimalisht përfshin elementet e mëposhtme:

- a) qëllimin e përdorimit të kredisë;
- b) llojin e kredisë (me këste, kufi etj.);
- c) kushtet e kredisë që lidhen me vlerën, njësinë monetare, datën e dhënies, datën e maturimit, normën nominale të interesit dhe llojin e saj (e ndryshueshme ose e pandryshueshme), indeksin orientues (norma e marrëveshjes së riblerjes e Bankës së Shqipërisë, norma e bonove të thesarit, libor, euribor, tabor etj.), marzhin, normën efektive të interesit, frekuencën e ndryshimit të normës së interesit apo pjesëve përbërëse të saj, vlerën periodike të shlyerjes së kredisë (kësti) dhe datat ose periudhën e shlyerjes;
- d) kontributin fillestar të kredimarrësit (nëse është e zbatueshme) ose komisione të ndryshme për marrjen dhe shlyerjen e kredisë;
- e) llojin e kolateralit (nëse ka);
- f) detyrimet dhe penalitetet e palëve dhe rastet kur ato lindin dhe zbatohen, veçanërisht kur subjekt i tyre është kredimarrësi;
- g) mënyrën e ndryshimit të kushteve të kontratës;
- h) mënyrën e përfundimit të kontratës;
- i) numrin e kopjeve të nënshkruara në origjinal të kontratës dhe mënyrën e disponimit të tyre nga palët.

2. Në procesin e livrimit të kredisë për herë të parë ose në momentin e ristrukturimit të saj, banka i ofron kredimarrësit:

- a) planin e shlyerjeve të kredisë në momentin e livrimit të saj dhe në rast ristrukturimi, sipas informacionit që disponohet në atë moment;
- b) planin e të gjitha pagesave të paracaktuara dhe të njohura, që kredimarrësi paguan në procesin e marrjes së kredisë dhe gjatë kohëvazhdimit të saj;
- c) penalitetet që zbatohen ndaj kredimarrësit dhe shembuj të mënyrës së llogaritjes së tyre;
- d) një koment të shkruar, ku i tërhiqet vëmendja kredimarrësit për rrezikun që paraqet për të:
 - huamarrja në valutë, veçanërisht në rastin kur të ardhurat e tij janë në lekë dhe mund të ketë lëvizje të pafavorshme të kursit të këmbimit lekë/valutë (ose e kundërta);
 - rritja e normës së interesit të kredisë gjatë kohëvazhdimit të saj, si rezultat i rritjes së indeksit orientues.

3. Në rastin e kredisë për konsum, përfshirë dhe kreditë për kartat e kreditit, ose në çdo formë tjetër kreditimi, në të cilin detyrimi i klientit ndaj bankës lind në formë automatike, kushtet e dhënies, të përdorimit dhe të kthimit të kredisë, së bashku me penalitetet përkatëse, duhet të shprehen në mënyrë të plotë në kontratën që lidhet me kredimarrësin.

Neni 8

Informacione të veçanta lidhur me marrëveshjet (kontratat) e kredisë

1. Banka, në rast se norma e ndryshueshme e interesit është llogaritur nëpërmjet shtimit ose zbritjes të një marzhi fiks në përqindje apo nga një indeks publik i ndryshueshëm, i siguron me shkrim kredimarrësit të paktën një herë në 12 muaj, informacionin e mëposhtëm:

- a) normën vjetore të interesit në fillim dhe në fund të periudhës përkatëse;
- b) pjesën e papaguar të kredisë në fillim dhe në fund të periudhës përkatëse;
- c) shumën e çdo kësti kredie, të përcaktuar sipas një plani pagesash dhe kohën kur duhet të paguhet çdo këst, bazuar në normën vjetore të interesit, të aplikuar në fund të periudhës përkatëse.

2. Banka, në rast se norma e interesit është llogaritur sipas një metode të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, në një periudhë maksimalisht prej 30 ditëve pas rritjes së normës vjetore të interesit me më shumë se 1 % nga norma e fundit e interesit e aplikuar, i siguron me shkrim kredimarrësit informacionin e mëposhtëm:

- a) normën e re të interesit dhe datën kur kjo normë bëhet e aplikueshme; dhe
- b) shumën e çdo kësti kredie dhe kohën kur duhet të paguhet çdo këst, për pagesat që do të ndikohen nga norma e re vjetore e interesit.

3. Banka, në rastin e marrëveshjeve të financimit (linjave të kredisë), i siguron me shkrim kredimarrësit informacionin e mëposhtëm:

- a) kufirin fillestar të kredisë, nëse është i njohur në momentin e dhënies së informacionit;

- b) normën vjetore të interesit ose metodën e llogaritjes nëse është e ndryshueshme;
 - c) llojin dhe shumën e çdo pagese të ndryshme nga interesat;
 - d) pagesën minimale, gjatë çdo periudhe pagesash ose metodën e llogaritjes të saj;
 - e) çdo periudhë për të cilën do të jepet një gjendje e llogarisë;
 - f) datën kur dhe pas llogaritën interesat dhe informacioni, në lidhje me çdo periudhë faljesh të aplikueshme;
 - g) të dhëna për komisionet dhe gjrobat;
 - h) pasurin/të e luajtshme apo të paluajtshme, nëse ka, mbi të cilën/at banka siguron kredinë.
4. Bankat, në rastin e lëshimit të kartave të kreditit, përveç informacionit sipas shkronjave “a” dhe “c” të paragrafit 3 të këtij neni, japin dhe informacionin e mëposhtëm:
- a) në rastin e kartave me:
 - i) normë fikse interesi, japin normën vjetore të interesit; ose
 - ii) normë të ndryshueshme të interesit, të llogaritur nëpërmjet shtimit ose zbritjes të një marzhi fiks në përqindje apo nga një indeks publik i ndryshueshëm, japin marzhin fiks në përqindje që i zbritet apo i shtohet dhe indeksin publik;
 - iii) mënyrën e llogaritjes së normës së interesit;
 - b) datën kur dhe pas të cilës, përllogaritën interesat dhe informacion në lidhje me çdo periudhë faljesh të aplikueshme;
 - c) nëse kredimarrësit i kërkohet në marrëveshjen e kredisë të paguajë të gjithë pjesën e pashlyer të kredisë me marrjen e gjendjes së llogarisë, atij i jepet:
 - i) përshkrimi i këtij detyrimi;
 - ii) periudha e faljes, në fund të së cilës kredimarrësi duhet të paguajë pjesën e pashlyer të kredisë; dhe
 - iii) norma vjetore e interesit të aplikueshëm mbi pjesën e pashlyer të kredisë, e cila nuk është paguar në kohën e duhur.
 - d) Banka, në rast se merr një njoftim nga kredimarrësi, në formë të shkruar apo dhe gojore, për një kartë krediti të humbur apo të vjedhur, nuk krijon detyrimin për kredimarrësin që ai të paguajë për transaksione të kryera me kartën e tij pas, bërjes së njoftimit.

Neni 9

Elemente të kontratës së llogarisë dhe depozitës

1. Për çdo llogari dhe depozitë të hapur nga klienti pranë bankës nënshkruhet një kontratë nga palët pjesëmarrëse në transaksion. Kontrata është një akt i veçantë, i ndryshëm nga dokumentet e aplikimit për hapjen e llogarisë.
2. Në kontratën e llogarive rrjedhëse dhe të kursimit, përveç të dhënave personale të klientit dhe numrit të llogarisë, përfshihen detyrimisht:
 - a) norma e interesit dhe mënyra e llogaritjes së saj;
 - b) frekuenca e pagesave të interesit;
 - c) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat personale nga interesat;
 - d) komisionet për mirëmbajtjen e llogarive;
 - e) komisione apo gjoba të tjera të aplikueshme.
 Elementet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” përfshihen në kontratë në rastet kur banka aplikon interes për llogarinë rrjedhëse dhe/ose llogarinë e kursimit.
3. Në kontratën e depozitave me afat, përveç të dhënave personale të klientit, përfshihen:
 - a) shuma e investuar në depozitën me afat;
 - b) norma vjetore e interesit;
 - c) shumën e interesit dhe frekuencën e pagesës së tyre;
 - d) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga interesi;
 - e) data e maturimit të depozitës;
 - f) kushtet e zgjedhura nga klienti për rinovimin e depozitës me afat;
 - g) kushtet e anulimit (prishjes) të kontratës; dhe
 - h) penalitetet e aplikueshme në rastin e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës.
4. Banka duhet të parashikojë në kontratën e llogarisë dhe të depozitës mënyrën e njoftimit të klientit për ndryshimin e kushteve apo afateve të kontratës së nënshkruar para se të aplikojë

ndryshimin.

5. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të treguara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni të kontratës së llogarisë dhe/ose të depozitës, vetëm për një klient ose një grup të kufizuar klientësh, banka është e detyruar të njoftojë paraprakisht me shkrim klientin ose klientët. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të lartpërmendura të kontratës së llogarisë dhe/ose të depozitës, që prek në mënyrë të njëjtë të gjithë klientët si rrjedhojë e politikave të bankës, kjo e fundit është e detyruar të njoftojë paraprakisht secilin prej tyre, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë.

Neni 10 **Marketingu**

1. Banka siguron që materialet promociionale të produkteve apo shërbimeve bankare të jenë të vërteta, të sqarojnë në mënyrë të plotë të gjitha kushtet e ofrimit të produkteve dhe/ose shërbimeve, dhe të mos përfshijnë informacion të pasaktë apo që zmadhon së tepërmi, ose përpriqet të fshehë veçori të produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

2. Në rastin e promovimit të karakteristikave preferenciale të shërbimeve (për shembull, normat e interesit), banka në të njëjtin promovim informon dhe mbi kushtet e veçanta të cilat duhen plotësuar për ta përfutur këtë shërbim.

3. Informacioni i përdorur për promovimin e produkteve dhe shërbimeve bankare bazohet në të dhëna të sakta, të verifikueshme, të hollësishme, në përputhje me parimin e mirëbesimit dhe të praktikave më të mira, me qëllim që t'i komunikojë publikut një informacion objektiv, të mjaftueshëm e të paanshëm.

Neni 11 **Konfidencialiteti**

1. Bankat ruajnë konfidencialitetin dhe/ose sekretin për të gjithë informacionin personal të klientit duke i garantuar këtij të fundit ruajtjen dhe administrimin e informacionit personal në sisteme të sigurta dhe të besueshme informacioni apo pagesash (transaksione, shërbime etj.).

2. Kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur:

a) banka detyrohet ta japë informacionin personal të klientit sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;

b) klienti kërkon me shkrim publikimin e këtij informacioni ose banka disponon lejen/autorizimin e tij me shkrim, për këtë qëllim.

3. Bankat i japin klientit, sipas kërkesës së tij, të gjithë informacionin e evidentuar për të.

4. Bankat janë të detyruara t'i japin klientit informacion bazë mbi depozitat e tij, të siguruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Neni 12 **Ankesat e klientëve**

1. Bankat i sigurojnë klientit informacionin e nevojshëm mbi procedurat për trajtimin e ankesave në mënyrë të shpejtë dhe të plotë.

2. Në rastin e një ankese me shkrim nga klienti, banka duhet t'i japë përgjigje me shkrim klientit mbi ankesën, brenda afatit kohor të përcaktuar në aktet rregullative të bankës.

3. Banka është e detyruar të mbajë të dhëna për çdo ankesë të klientelës që ka lidhje me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, informacion mbi zgjidhjen e këtyre ankesave, si dhe të dhëna të tjera plotësuese të nevojshme.

4. Bankat evidentojnë në një regjistër të veçantë ankesat e klientit, si dhe hartojnë procedura dhe rregulla të brendshëm për trajtimin e tyre.

KREU III DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në nenet 74 deri 91 të ligjit “Për bankat” dhe në aktet e tjera nënligjore, në zbatim të tij.

Neni 14

Dispozitë shfuqizuese

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk do të zbatohen për kreditë dhe/ose depozitat ndërbankare.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kreditë e miratuara dhe/ose depozitat e pranuar, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

ANEKSI NR.1

METODA E LLOGARITJES SË NORMËS EFEKTIVE TË INTERESIT PËR KREDINË

Ekuacioni bazë, për llogaritjen e normës efektive të interesit (NEI), barazon, mbi një bazë vjetore, nga njëra anë vlerën totale faktike të kredisë (*total present value of draws*, duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj.), të vënë në dispozicion të klientit sipas marrëveshjes së kredisë dhe në anën tjetër vlerën totale faktike (*total present value of repayments and payments of charges*) të shlyerjeve dhe/ose pagesave të shpenzimeve:

$$\sum_{k=1}^m K_k (1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-tl}$$

Kuptimi i shkronjave dhe simboleve:

m - është numri total i kësteve të kredisë, nëse livrimi i kredisë bëhet me këste (*cash flow-ve*), të paguar nga kredidhënësi.

k - është numri në vazhdimësi për këstet e kredisë, nëse livrimi i kredisë bëhet me këste (*cash flow-t*), të paguara nga kredidhënësi (*drawn*), kështu që $1 < k < m$ dhe/ose $1 = k = m$.

K_k - është vlera faktike e kredisë (*cash flow*) së vënë në dispozicion të klientit në periudhën k.

tk - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së kështit të parë të kredisë (*first cash flow*) të vënë në dispozicion të klientit (nëse livrimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kështi pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë $t_l = 0$.

m' - është numri total i kësteve (*cash flow-ve*) të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve.

I - është numri në vazhdimësi i kësteve të paguara nga klienti (*cash flow-ve*) për shlyerjen e kredisë (shlyerja ose pagesa e shpenzimeve).

RI - është vlera e kështit të shlyerjes (*cash flow*) ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l.

tl - intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së kështit të parë të kredisë të vënë në dispozicion të klientit (nëse livrimi i kredisë bëhet me këste) ose datës së livrimit të kredisë, në rast se livrimi i kredisë bëhet i plotë (*first cash flow*) dhe datës së çdo kështi për shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese që paguan klienti.

i=NEI mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) kur termat e tjerë në ekuacion janë të njohur nga kontrata ose ndryshe.

Shënime:

a) Shumat e paguara nga të dyja palët në kohë të ndryshme nuk është e nevojshme të jenë të barabarta dhe të paguhen në intervale të barabarta.

b) Data e fillimit duhet të jetë ajo e pagimit të kështit të parë të livrimit të kredisë nga banka, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste ose e datës së livrimit të kredisë, në rast të livrimit të plotë të kredisë në dispozicion të klientit.

c) Intervalet midis datave të përdorura në llogaritjet duhet të shprehet në vite ose fraksione të vitit. Një vit presupozohet të ketë 365 ditë ose 366 ditë për vitet e brishtë, 52 javë ose 12 muaj. Një muaj presupozohet të ketë 30,41666 ditë (365/12) pavarësisht nëse është ose jo vit i brishtë.

d) Rezultatet e llogaritjes duhet të shprehen me një saktësi, të paktën një vlerë pas presjes dhjetore.

e) Ekuacioni mund të rishkruhet duke përdorur një shumë të vetme në rast të livrimit të plotë të kredisë nga banka:

$$S = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-tl}$$

S - është vlera totale faktike e kredisë (*total present value of drawdowns*) duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur për shembull, shpenzimet administrative etj.

Bankat duhet të sigurojnë që metodat e zgjidhjes së aplikueshme të japin një rezultat të barabartë me atë të shembujve të paraqitur në këtë aneks (shih më poshtë).

Shembuj:

I. Llogaritja e NEI- mbi baza kalendarike (1 vit=365 ditë ose 366 ditë për vitin e brishtë)

Shembulli 1:

Shuma e kredisë: 1000 euro, dhënë më 1 janar 1994. Kredia paguhet me një pagesë të vetme prej 1,200 eurosh në 1 korrik 1995 për shembull, 1.5 vjet ose 546 (365+181) ditë pas ditës së dhënies së kredisë.

Ekuacioni shndërrohet:

$$1000 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{546}{365}}}$$

ose:

$$(1+i)^{546/365} = 1.2$$

$$1+i=1.129624$$

$$i=0.1296204$$

Kjo vlerë do të rumbullakoset në 13% (ose 12.96% nëse kërkohet saktësia me dy shifra dhjetore).

Shembulli 2:

Shuma e kredisë është 1000 euro, por kredimarrësit i mbahen 50 euro për shpenzime administrative. Kështu, kredia është në fakt 950 euro. Shlyerja e 1200 eurove, si edhe në shembullin e parë, bëhet në 1 korrik 1995.

Ekuacioni shndërrohet

$$950 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{546}{365}}}$$

ose:

$$(1+i)^{546/365} = 1.263157$$

$$1+i=1.169026$$

$$i=0.169026$$

kjo shifër do të rrumbullakoset në 16.9%

Shembulli 3:

Shuma e kredisë është 1000 euro, në 1 janar 1994, e ripagueshme në dy shuma, secila prej 600 eurosh, e pagueshme respektivisht pas një dhe dy vitesh.

Ekuacioni shndërrohet:

$$1000 = \frac{600}{(1+i)} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{730}{365}}} = \frac{600}{(1+i)} + \frac{600}{(1+i)^2}$$

Zgjidhja e të cilit rezulton në $i=0.1306623$ të rrumbullakosur në 13.1 % (ose 13.07 nëse preferohet saktësi në dy shifra dhjetore).

Shembulli 4:

Shuma e kredisë është 1000 euro, e dhënë në datën 1 janar 1994 ndërsa shumat për t'u paguar nga kredimarrësi janë:

Pas 3 muajsh (0.25 vjetë/90 ditësh):	272 euro
Pas 6 muajsh (0.5 vjetësh/181 ditësh):	272 euro
Pas 12 muajsh (1 viti/365 ditësh):	<u>544 euro</u>

Totali: 1088 euro

Ekuacioni shndërrohet në:

$$1000 = \frac{272}{(1+i)^{\frac{90}{365}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{181}{365}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{365}{365}}}$$

Rezultati i këtij ekuacioni është $i=0.13226$, e rrumbullakosur në 13.2% (ose 13.23% nëse kërkohet një saktësi në 2 shifra dhjetore).

II. Llogaritja e NEI në bazë të një viti standard (1 vit = 365 ditë ose 365.25 ditë, 52 javë ose 12 muaj të njëjtë)

Shembulli 1:

Shuma e kredisë: 1000 euro. Kredia do të paguhet me një pagesë të vetme prej 1200 eurosh pas 1.5 vitesh (për shembull, $1.5 \times 365 = 547.5$ ditësh, $1.5 \times 12 = 18$ muaj ose $1.5 \times 52 = 78$ javë).

Ekuacioni shndërrohet:

$$1000 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.5}{365}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.875}{365.25}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{18}{12}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{78}{52}}}$$

ose: $(1+i)^{1.5} = 1.2$

$$1+i=1.129243$$

$$i = 0.129243$$

Kjo shifër do të rrumbullakoset në 12.9 për qind (ose 12.92% nëse preferohet një saktësi në 2 shifra dhjetore).

Shembulli 2;

Shuma e kredisë është 1000 euro, por kredimarrësit i mbahen 50 euro për shpenzime administrative, kështu që kredia është në fakt 950 euro. Shlyerja e 1200 eurove, si dhe në shembullin e parë, bëhet 1.5 vjet pas marrjes së kredisë.

Ekuacioni shndërrohet:

$$950 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.5}{365}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.875}{365.25}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{18}{12}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{78}{52}}}$$

ose:

$$\begin{aligned}(1+i)^{1.5} &= 1200/950 = 1.263157 \\ 1+i &= 1.168526 \\ i &= 0.168526\end{aligned}$$

Kjo shifër do të rrumbullakoset në 16.9% (ose 16.85 nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

Shembulli 3:

Shuma e kredisë është 1000 euro, e ripagueshme në dy shuma, secila prej 600 eurosh, e pagueshme respektivisht pas një dhe dy vitesh.

Ekuacioni shndërrohet:

$$\begin{aligned}1000 &= \frac{600}{(1+i)^{\frac{365}{365}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{730}{365}}} = \frac{600}{(1+i)^{\frac{365.25}{365.25}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{730.5}{365.25}}} \\ &= \frac{600}{(1+i)^{\frac{12}{12}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{24}{12}}} = \frac{600}{(1+i)^{\frac{52}{52}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{104}{52}}} \\ &= \frac{600}{(1+i)^1} + \frac{600}{(1+i)^2}\end{aligned}$$

nga ku $i = 0.13066$ e rrumbullakosur në 13.1% (ose 13.07 % nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

Shembulli 4:

Shuma e kredisë është 1000 euro dhe shumat për t'u paguar nga kredimarrësi janë:

Pas 3 muajsh

(0.25 vjetë/13 javësh/91.25 ditësh/91.3125 ditësh): 272 euro

Pas 6 muajsh

(0.5 vjetësh/26 javësh/182.5 ditësh/182.625 ditësh):	272 euro
Pas 12 muajsh	
(1 viti/52 javësh/365 ditësh/355.25 ditësh):	<u>544 euro</u>
Totali:	1088 euro

Ekuacioni shndërrohet:

$$\begin{aligned}
 1000 &= \frac{272}{(1+i)^{\frac{91.25}{365}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{182.5}{365}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{365}{365}}} \\
 &= \frac{272}{(1+i)^{\frac{91.3125}{365.25}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{182.625}{365.25}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{365.25}{365.25}}} \\
 &= \frac{272}{(1+i)^{\frac{3}{12}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{6}{12}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{12}{12}}} \\
 &= \frac{272}{(1+i)^{\frac{13}{52}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{26}{52}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{52}{52}}} \\
 &= \frac{272}{(1+i)^{0.25}} + \frac{272}{(1+i)^{0.5}} + \frac{544}{(1+i)^1}
 \end{aligned}$$

Nga ku $i = 0.13185$ e rumbullakosur në 13.2% (ose 13.19 % nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

ANEKSI NR.2

NJOFTIM PËR KOMISIONET E SHËRBIMIT ME KARTË

Klientë, kujdes!

1. Kjo ATM është e vendosur nga banka _____.
2. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në *cash*, duke përdorur kartën e debitit (_____) të lëshuar nga banka jonë. Për këtë shërbim ju paguani një komision _____.
3. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në *cash* duke përdorur kartën e kreditit (_____) të lëshuar nga banka jonë. Për këtë shërbim ju paguani një komision prej _____.
4. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në *cash* edhe me karta të lëshuara nga banka të tjera, por në këto raste ju do të paguani edhe një komision për transaksionin që banka jonë do të kryejë me bankën, që ju ka lëshuar kartën.
5. Banka jonë nuk mban asnjë përgjegjësi dhe nuk rimbursen komisionet që ju do të paguani për shërbimet e ofruara në këtë ATM, me karta të bankave të lëshuara nga banka të tjera.
6. Banka jonë është gjithnjë në shërbimin tuaj.
7. Për çdo problem dhe informacion të nevojshëm, lutem kontaktoni bankën tonë me këtë numër telefoni _____.

VENDIM
Nr.60, datë 29.8.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KËRKESAT MINIMALE TË PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT NGA BANKAT
DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 47, pikat 3 dhe 4 dhe të nenit 53 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR KËRKESAT MINIMALE TË PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT NGA BANKAT DHE
DEGËT E BANKAVE TË HUAJA

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objkti

Objkti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale, i mënyrave dhe afateve lidhur me informacionin që duhet publikuar në raportet periodike të bankave dhe degëve të bankave të huaja, në funksion të rritjes së transparencës dhe nxitjes së disiplinës në tregun bankar, si dhe për të siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit bankar.

Neni 2

Subjektet

Subjekte të kësaj rregullore janë bankat dhe degët e bankave të huaja (që më poshtë për thjeshtësi do të quhen me emrin e përbashkët “banka”), të cilat janë të licencuara të ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12 dhe shkronjës “c” të nenit 43, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji “Për Bankën”) të pikës 2, të nenit 47, pikat 3 dhe 4 dhe të nenit 55 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë ligji “Për bankat”).

Neni 4

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit “Për bankat”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Publikim” është vënia në dispozicion e informacionit për përdoruesit: publikun, pjesëmarrësit e tregut, investitorët, punonjësit, kreditorët, klientët, qeveritë dhe organizmat e tjerë sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

b) “Informacion cilësor” është informacioni mbi objektivat, politikat dhe strategjitë e shkruara të bankës, metodat, proceset, strukturën, organizimin e funksionet e administrimit të rreziqeve, qeverisjen e bankës, politikat kontabël të përdorura etj.

c) “Informacion sasior” janë të dhënat numerike të përmbledhura për zërat e bilancit, për të ardhurat dhe shpenzimet, për madhësinë e ekspozimeve të bankës ndaj rreziqeve të ndryshme, klasifikimeve brenda portofoleve të kredisë, madhësinë e provigjoneve për humbjet kryesisht nga rreziku i kredisë etj.

d) “Informacion material” është informacioni, i cili nëse nuk pasqyrohet ose shtrembërohet, mund të ndryshojë ose të ndikojë në vlerësimin ose vendimin e një përdoruesi, që mbështetet në këtë informacion.

e) “Informacion privat” është informacioni për produktet, shërbimet dhe sistemet e informacionit të një banke, publikimi i të cilit mund të dëmtojë pozicionin konkurrues të bankës në treg.

f) “Informacion konfidencial” është informacioni mbi klientët dhe/ose palët e tjera që lidhin kontrata me bankën, dhe që ruhet si i tillë (konfidencial) në bazë të akteve ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi.

Neni 5

Kategoritë e informacionit

1. Bankat publikojnë raportet periodike, që përfshijnë informacionin sipas gjashtë kategorive kryesore¹:

- a) veprimtaria kryesore e bankës, organizimi dhe drejtimi i përgjithshëm;
- b) ecuria (performanca) financiare;
- c) gjendja financiare (duke përfshirë kapitalin, aftësinë paguese dhe likuiditetin);
- d) praktikat dhe strategjitë e administrimit të rrezikut;
- e) ekspozimet ndaj rreziqeve (duke përfshirë rrezikun e kredisë, rreziqet e tregut, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional, ligjor dhe rreziqet e tjera); dhe
- f) politikat kontabël.

2. Bankat pasqyrojnë këto kategori të informacionit, në përshtatje me vëllimin e veprimtarisë së tyre dhe me natyrën e operacioneve që ato ndërmarrin, duke respektuar nivelin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje.

3. Informacioni që përfshihet në kategoritë e mësipërme paraqitet qartë dhe në mënyrë të përshtatshme, me qëllim që të arrihet një nivel i mjaftueshëm i transparencës bankare.

4. Bankat dërgojnë në Bankën e Shqipërisë një kopje të publikimeve të tyre.

5. Bankat nuk publikojnë informacione të klasifikuara në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si konfidenciale ose sekret mbi klientelën e tyre, apo informacione që ndikojnë në pozicionin konkurrues të tyre në treg.

Neni 6

Kërkesat për procedurat e publikimit dhe karakteristikat e informacionit

1. Bankat hartojnë dhe miratojnë akte të brendshme për procedurat e përgatitjes dhe publikimit

¹ Klasifikimi bëhet nga Komiteti i Bazelit.

të informacionit, si dhe për kontrollin e brendshëm në procesin e përgatitjes dhe publikimit, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së publikimeve si vlefshmërinë, integritetin, saktësinë dhe frekuencën e tyre.

2. Aktet e brendshme të bankës për publikimin e informacionit përcaktojnë informacionin, i cili do të klasifikohet material, privat dhe konfidencial, ndarjen e tij sipas kategorive të përdoruesve (depozitues, analistë, kredimarrës të mëdhenj, investitorë të mundshëm dhe/ose kategori të tjera përdoruesish), mjetet e tjera të komunikimit masiv që do të përdoren për publikim, përveç publikimeve me bazë letër, si dhe çështje të tjera me rëndësi për bankën.

3. Bankat publikojnë informacion mbi rreziqet ndaj të cilave ekspozohen në veprimtarinë e tyre, duke dhënë një pamje të gjithanshme të profilit të rrezikut.

4. Informacioni i publikuar nga bankat duhet të jetë material, që t'i shërbejë kërkesave vendimmarrëse të përdoruesve të tij dhe t'i ndihmojë ata në vlerësimin e rreziqeve dhe fitimeve të pritshme të investimeve të tyre, të ekspozimeve të tjera të mundshme dhe të ecurisë e të gjendjes financiare të ardhshme të veprimtarisë së bankave.

5. Bankat publikojnë informacionin me shtrirje kohore të mjaftueshme (periudha nga fundi i periudhës së raportuar deri në publikim), për të dhënë një pamje të kuptueshme të profilit të rrezikut të bankave dhe administrimit të tij.

6. Bankat publikojnë informacion të besueshëm, që pasqyron përmbajtjen ekonomike të ngjarjeve. Ky informacion duhet të jetë i verifikueshëm në çdo kohë, i plotë në të gjitha aspektet që paraqesin rëndësi për përdoruesin.

7. Bankat publikojnë të dhëna dhe tregues numerikë në raportet e publikuara, që kanë bazë krahasuese dhe që i referohen një ose disa periudhave të njëjta.

KREU II

MËNYRA DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT

Neni 7

Mënyra e publikimit të informacionit

1. Bankat publikojnë informacionin në gjuhën shqipe në një mënyrë të përshtatshme (të tillë si broshura informative ose/dhe në formë elektronike apo të afishuar në një tabelë njoftimi) në ambiente të përdorshme nga publiku, në zyrat qendrore dhe në të gjitha degët dhe agjencitë e tyre.

2. Bankat publikojnë informacionin në faqen e internetit, e cila punon jo më pak se 95 për qind të vitit.

3. Bankat marrin masat, që informacioni të jetë në përdorim deri në publikimin tjetër të radhës.

4. Bankat publikojnë informacionin në gjuhën shqipe dhe mbi baza vullnetare edhe në gjuhë të huaj.

5. Bankat përdorin si shenjë dalluese në publikimet e tyre stemën e bankës.

Neni 8

Afatet e publikimit

1. Bankat publikojnë informacionin sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, në raportet e tyre periodike.

2. Raporti i vlefshëm për periudhat tremujore (31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator) publikohet brenda muajit pasardhës, pas mbarimit të tremujorit kalendarik. Ndërsa, raporti i tremujorit të katërt të vitit (31 dhjetorit) publikohet brenda muajit mars të vitit pasardhës. Raporti i plotë vjetor, publikohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Bankat shënojnë datën në të cilën publikojnë raportin dhe datën kur plotësojnë ose korrigjojnë informacionin e publikuar më parë, apo në rastin e publikimit të një informacioni shtesë apo plotësues, që i referohet të njëjtë informacion.

4. Informacioni sasior, që publikohet në raportet periodike tremujore, përfshin informacionin për tremujorin aktual së bashku me informacionin krahasues për periudhat e mëparshme.

KREU III KËRKESAT MINIMALE PËR PUBLIKIM

Neni 9

Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, administrimin, drejtimin dhe kontrollin e bankave

1. Bankat publikojnë informacion rreth veprimtarisë/ve për të cilën/at janë licencuar, informacion mbi strukturën e aksionerëve, strukturën e organeve drejtuese dhe strukturën organizative të tyre.

2. Bankat publikojnë informacionin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, sipas aneksit 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Informacion mbi ecurinë e gjendjes financiare të bankave

Bankat publikojnë informacionin bazë mbi ecurinë dhe gjendjen financiare, që përmban kryesisht:

1. bilancin kontabël (aktiv-pasivet) dhe një informacion mbi zërat jashtë bilancit (transaksionet jashtë bilancit, angazhimet e financimit, instrumentet derivative etj.). Në shënimet sqaruese të bilancit jepet informacion shtesë për zërat e bilancit që i shërbejnë ose kanë lidhje me kërkesat e përdoruesve;

2. pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas natyrës ose funksionit brenda tyre, si dhe shënimet sqaruese që shoqërojnë këtë pasqyrë, të cilat japin të dhëna shtesë mbi kategoritë e rëndësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve;

3. treguesit kryesorë të rentabilitetit, që përfshijnë treguesin e kthyeshmërisë nga aktivet (ROA), nga kapitali aksioner (ROE), marzhin neto nga interesat (të ardhurat neto nga interesat/aktivet mesatare që sjellin të ardhura), raportin e shpenzimeve me të ardhurat etj.;

4. kapitalin rregullator, vlerën, elementet përbërëse dhe veçoritë e tij, veçanërisht në rastin e instrumenteve hibride, me qëllim që pjesëmarrësit e tregut të njohin aftësinë e bankave për të përballuar humbjet financiare. Këto publikime duhet të përfshijnë minimalisht strukturën e kapitalit rregullator me elementet përbërëse të tij;

5. mjaftueshmërinë e kapitalit, me qëllim që pjesëmarrësit e tregut të njohin lidhjen midis kapitalit të publikuar dhe ekspozimit dhe vlerësimit të rrezikut, duke përfshirë:

a) raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi baza individuale dhe të konsoliduara për periudha tremujore;

b) vlerësime të ekspozimeve të rrezikut, të llogaritura sipas metodologjisë së përcaktuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë apo modeleve të brendshme të bankës;

c) analiza mbi faktorët kryesorë, që ndikojnë në pozicionin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

6. informacionin e parashikuar në këtë nen, sipas aneksit 2, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Informacion mbi ekspozimet ndaj rreziqeve

1. Bankat publikojnë informacion mbi parimet e përgjithshme, politikat dhe metodologjitë e administrimit të rrezikut, si dhe teknikat e zbutjes së rrezikut (për shembull instrumentet derivative).

2. Bankat identifikojnë dhe pasqyrojnë në informacionet që publikojnë, të gjitha rreziqet që janë të rëndësishme dhe relevante. Bankat publikojnë informacion kryesor cilësor dhe sasior lidhur me administrimin e rreziqeve të tilla, si më poshtë:

a) Për rrezikun e kredisë, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

i) Informacion të përgjithshëm mbi politikat, strategjitë dhe metodat për identifikimin, administrimin, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, duke përfshirë rolin e këshillit drejtues dhe të drejtuesve të tjerë ekzekutivë.

ii) Përkufizimin e kredive me probleme, kredive që u ka kaluar afati dhe kredive të ristrukturuara.

iii) Metodatat e ndjekura për provigjionet statistikore dhe provigjionet për humbjet nga kreditë, si dhe të metodave statistikore të përdorura nga vetë banka (nëse ekzistojnë të tilla).

iv) Metodatat dhe instrumentet e përdorura nga bankat, për të zbutur rrezikun e kredisë.

v) Llojet kryesore të kolateralit të pranuar nga bankat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e tij.

Informacion sasior

i) Tepërcën e kredive (bruto) dhe klasifikimin sipas kategorive respektive (standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura).

ii) Totalin e provigjioneve sipas kategorive respektive të kredive të klasifikuara.

iii) Totalin e kredive (bruto) të ristrukturuara gjatë periudhës korrente.

iv) Vlerën e instrumenteve derivative për operacionet e mbulimit (*hedging*) dhe/ose në tërësi, të përdorura në veprimtarinë e bankës.

v) Klasifikime të portofolit të kredive sipas llojit, shpërndarjes gjeografike, sipas industrisë ose tipit të kundërpartisë, sipas maturitetit të mbetur dhe shumën e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme.

vi) Vlerën e portofolit të kredive që sigurohen nga kolateralet e dhëna, garantuesit dhe/ose instrumentet derivative.

b) Për rreziqet e tregut, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

Informacion të përgjithshëm mbi politikat e administrimit, metodat statistikore të përdorura në modelet e vlerësimit të rreziqeve, vlefshmërinë e modeleve të tyre dhe procedurat *stress- test*.

Informacion sasior

Kërkesat e kapitalit për rrezikun e normës së interesit, rrezikun nga kursi i këmbimit, si dhe vlerësimet VAR (nëse kryhen nga bankat).

c) Për rrezikun e normës së interesit, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

i) Informacion të përgjithshëm mbi strategjitë dhe politikat e administrimit të këtij rreziku, si dhe mbi rolin e këshillit drejtues dhe drejtuesve të tjerë ekzekutivë në zhvillimin, rishikimin, miratimin dhe zbatimin e politikave të rrezikut të normës së interesit dhe programin, për monitorimin dhe kontrollin efektiv të këtij rreziku.

ii) Metodatat për matjen e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit.

iii) Në rastin e përdorimit të instrumenteve derivative, bankat duhet të publikojnë mënyrën e përdorimit të këtyre instrumenteve në administrimin e rrezikut të normës së interesit si dhe një informacion mbi shtrirjen e përdorimit të tyre.

Informacion sasior

Të dhëna numerike të hollësishme për nivelin e aktiveve dhe pasiveve, të ndjeshme ndaj

normës së interesit dhe të ekspozimeve jashtë bilancit, të shoqëruara me skenarët përkatës (nëse ka) mbi lëvizjet e normave të interesit të përcaktuara nga banka.

d) Për rrezikun e kapitalit aksioner, bankat publikojnë llojet, vlerën dhe natyrën e investimeve në shoqëritë publike dhe private, si dhe rezultatin financiar të tyre.

e) Për rrezikun e kursit të këmbimit, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

i) Informacion të përgjithshëm mbi politikat dhe procedurat e identifikimit, administrimit, monitorimit dhe kontrollit të rrezikut të normës së këmbimit.

ii) Burimet kryesore të rrezikut të kursit të këmbimit brenda portofolit të aktiveve në valutë, teknikat e përdorura për matjen e këtij rreziku, kufizimet që ato përcaktojnë dhe frekuencën e vlerësimit.

iii) Në rastin e përdorimit të instrumenteve derivative, bankat duhet të publikojnë mënyrën e përdorimit të këtyre instrumenteve për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit, si dhe një informacion mbi shtrirjen e përdorimit të tyre.

Informacion sasior

i) Ekspozimet e bankës në monedha të veçanta dhe në tërësi, për gjithë monedhat.

ii) Të dhëna mbi vlerën e investimeve të bankës në filialet e huaja (rreziku i konvertimit të monedhës së huaj).

f) Për rrezikun operacional, bankat publikojnë llojet kryesore të ekspozimeve ndaj rrezikut operacional, si dhe një përshkrim cilësor të përgjithshëm të modeleve të tyre, për të administruar dhe kontrolluar këtë lloj rreziku (nëse ekzistojnë të tilla).

g) Për rrezikun e likuiditetit, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

i) Informacion të përgjithshëm për administrimin e likuiditetit, duke përfshirë zhvillimin, rishikimin, miratimin dhe zbatimin e politikave të administrimit të likuiditetit dhe procedurat e vendosura për monitorimin dhe kontrollin efektiv të këtij rreziku.

ii) Metodat e përdorura për vlerësimin e gjendjes aktuale të likuiditetit dhe parashikimin e nevojave për të ardhmen.

iii) Metodat e përdorura për administrimin e likuiditetit.

Informacion sasior

i) Niveli i aktiveve likuide dhe burimeve e përdorimeve të fondeve të bankave.

ii) Niveli i aktiv-pasiveve afatshkurtra.

iii) Niveli i burimeve të fondeve nga të tretët sipas maturitetit të mbetur.

iv) Një pasqyrë e fluksit të rrjedhjes së parave (*cash flow-t*).

v) Vlera e aktiveve të titullzuara etj. (nëse ka).

3. Bankat publikojnë informacionin e parashikuar në këtë nen, sipas aneksit 2, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 12

Informacion mbi politikat kontabël

1. Bankat publikojnë informacion mbi politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare, në mënyrë që përdoruesi i informacionit të njohë si vlerësohen zërat e ndryshëm në këto pasqyra, për një interpretim të saktë të informacionit.

2. Bankat publikojnë informacion mbi politikat kontabël të përdorura për vlerësimin e aktiv - pasiveve, provigjoneve, të ardhurave etj.

KREU IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në nenin 53, pika 5 dhe nenin 89 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

ANEKSI NR.1

1. Informacion i përgjithshëm mbi bankën (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

1.1 Bankat publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike, adresën e regjistruar, numrin dhe datën e vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

b) shumën e kapitalit të regjistruar sipas vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

c) shumën e kapitalit të paguar;

d) tipin, formën, numrin e aksioneve të emetuara dhe vlerën nominale të tyre;

e) informacion mbi rritjet e kapitalit, nëse ka rritje të tij që nga publikimi i fundit mbi:

- mënyrën dhe nivelin e rritjes së kapitalit;

- tipin, formën, numrin e aksioneve të emetuara, vlerën nominale të tyre (në rastin e emetimit të një aksioni të ri);

- shumën e rritjes së kapitalit, burimin (fondet) e rritjes (në rastin e rritjes së kapitalit nga fondet e veta) dhe nëse rritet vlera nominale e aksioneve, jepet shuma sipas të cilës ajo do të rritet.

1.2 Bankat publikojnë informacion mbi aksionerët që kanë pjesëmarrje influencuese.

a) Në rastin e aksionerëve - persona juridikë, bankat publikojnë:

1. emrin tregtar;

2. formën juridike;

3. adresën e regjistruar;

4. përqindjen e aksioneve me të drejta votimi.

b) Në rastin e aksionerëve - persona fizikë, bankat publikojnë:

1. emrin dhe mbiemrin;

2. përqindjen e aksioneve me të drejta votimi.

2. Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave të huaja (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

Degët e bankave të huaja publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike, selinë, numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit;

b) shumën e kapitalit të dhuruar;

c) shumën e kapitalit të dhuruar, të paguar.

3. Informacion mbi strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës dhe degës së bankës së huaj, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre dhe marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime)

3.1 Bankat publikojnë informacion mbi administrimin e bankës:

a) strukturën organizative, numrin e njësive organizative dhe numrin e punonjësve;

b) strukturën e organeve drejtuese si këshillit drejtues dhe drejtorisë, autoritetet dhe përgjegjësitë e tyre;

c) kualifikimet dhe përvojën e anëtarëve të këshillit drejtues, komitetit të kontrollit dhe drejtuesve ekzekutivë të bankave;

d) strukturën e pronësisë (për shembull, aksionerët kryesorë dhe të drejtat e votimit), pjesëmarrjen e aksionerëve kryesorë në këshillin drejtues ose në drejtorinë e bankës;

e) kodin e etikës dhe politikën e drejtimit të veprimtarisë, në veçanti përmbajtja e ndonjë kodi apo politike qeverisëse dhe procesi sipas të cilit është zbatuar apo një vlerësim nga këshilli drejtues i performancës së tij lidhur me këtë kod ose politikë;

f) politikën e bankës lidhur me konfliktet e interesave, si dhe natyrën dhe nivelin e transaksioneve me filialet dhe personat/klientët e lidhur.

3.2 Bankat publikojnë informacion mbi strukturën e grupit të konsoliduar, të cilit ato i përkasin (nëse ekziston grupi bankar):

1. emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve që përbëjnë grupin e konsoliduar, ndërsa në rastin e personit fizik, jepet emri dhe mbiemri;

2. emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve në të cilat bankat janë sipërmarrje mëmë ose aksionere kryesore;

3. emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve, të cilat janë sipërmarrje mëmë ose aksionere kryesore në banka;

4. Informacion mbi aktivitetet e bankave (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

Bankat publikojnë informacion mbi aktivitetin e tyre si më poshtë:

a) një listë të veprimtarive sipas licencës së marrë;

b) një listë të veprimtarive që ato aktualisht kryejnë.

5. Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrjet në të cilat bankat janë aksionere kryesore (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

Bankat publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar;

b) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në kapitalin e një sipërmarrjeje të tillë;

c) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në të drejtat e votimit në një sipërmarrje të tillë;

d) çdo mënyrë tjetër të kontrollit të ushtruar;

e) numrin, vlerën nominale dhe çmimin e blerjes të aksioneve dhe çdo ndryshim të bërë gjatë periudhës aktuale;

f) shumën e vlerave për t'u arkëtuar dhe për t'u paguar nga bankat në lidhje me një sipërmarrje të tillë;

g) shumën e letrave me vlerë, të cilat janë lëshuar nga sipërmarrjet e tilla dhe shumën e vlerave të pagueshme nga letra të tilla me vlerë;

h) shumën e garancive të lëshuara nga bankat për sipërmarrje të tilla dhe shumën e garancive të pranura nga bankat, nga sipërmarrje të tilla.

6. Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksionere kryesore në banka (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

6.1 Bankat publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar (në rastin e personit fizik jepet emri dhe mbiemri);

b) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në kapitalin e bankave;

c) përqindjen e pjesëmarrjes, direkte ose indirekte, të të drejtave të votimit të bankave;

d) ndonjë mënyrë tjetër e kontrollit, e ushtruar;

e) shumën e vlerave të arkëtueshme dhe të pagueshme të bankave ndaj sipërmarrjeve të tilla;

f) shumën e letrave me vlerë të cilat janë emetuar nga sipërmarrje të tilla, dhe shumën e vlerave të pagueshme (bank's payables) nga këto letra me vlerë;

g) shumën e garancive të lëshuara nga bankat për këto sipërmarrje dhe shumën e garancive të pranura nga bankat për sipërmarrje të tilla.

6.2 Në rastin e një sipërmarrjeje mëmë në një banke, është i mjaftueshëm publikimi i informacionit sipas paragrafit 4.1.

7. Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë (çdo tremujor).

Dega e bankës së huaj publikon raportet financiare tremujore dhe vjetore të bankës – mëmë si më poshtë:

a) raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) kapitalin rregullator (fondet e veta);

c) treguesin e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë;

d) treguesin e kredisë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (fondet e veta);

e) treguesin e shumës së fondeve rezervë për humbjet nga kreditë ndaj kredive me probleme;

f) treguesin e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve;

g) raportet financiare tremujore më të fundit të bankës-mëmë;

- h) raportin më të fundit të ekspertit kontabël të autorizuar për bankën-mëmë;
i) vlerësimin e performancës së bankës-mëmë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit (shoqëritë e *rating-ut*).

ANEKSI NR.2

A. Informacion mbi ecurinë e gjendjes financiare të bankave (çdo tremujor)

Tabela 1

Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabilitetit

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm në formën e analizave dhe komenteve të shkruara, për ecurinë e gjendjes financiare të bankës sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
Informacion sasior	b)	- Bilanci kontabël (aktiv-pasivet) dhe zërat jashtë bilancit (formularët nr. 20, 21 dhe 23 sipas SRU); - Pasqyra e llogarisë “të ardhura dhe shpenzime” (formulari nr.22, sipas SRU); - Tregues të rentabilitetit si më poshtë: 1. kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) = të ardhurat neto/aktivet mesatare *100; 2. rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare; 3. shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 4. të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë; 5. kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar *100; 6. aktive për punonjës = totali i aktiveve/ numri i regjistruar i punonjësve; 7. të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare; 8. të ardhurat nga interesat / aktivet mesatare; 9. shpenzime për interesa / aktivet mesatare; 10. të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 11. të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare; 12. shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 13. shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 14. shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.

Tabela 2

Struktura e kapitalit rregullator
(SRU formulari nr.30, udhëzimi “Për kapitalin rregullator të bankës”)

Informacion cilësor	a)	Informacion i përmbledhur mbi veçoritë kryesore të instrumenteve të kapitalit, veçanërisht në rastin e instrumenteve hibride
Informacion sasior	b)	Kapitali bazë (1+2). Elemente përbërëse që shtohen (1): - kapitali i nënshkruar; - rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit); - primet e emetimit dhe të fuzionimit (shkrirjes, bashkimit); - fitimet e pashpërndara (të bartura); - fitimi ushtrimor i fundit të vitit; - fitimi ushtrimor i periudhës raportuese; - diferenca rivlerësimi kreditore.

	Elemente përbërëse që zbriten (2): - kapitali i nënshkruar, i papaguar; - vlera emërore e aksioneve të bankës të mbajtura nga banka (të pashitura, të riblera); - humbjet e pashpërndara (të bartura); - humbja ushtrimore; - diferenca rivlerësimi debitore; - aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara.
c)	Kapitali shtesë (3) Elemente përbërëse të kapitalit shtesë (3): - rezervat e rivlerësimit; - rezervat e përgjithshme; - detyrimet e varura: instrumentet hibride dhe detyrimet e varura me afat;
d)	Zbritjet nga kapitali bazë dhe shtesë sipas udhëzimit dhe akteve të tjera rregullative të Bankës së Shqipërisë.
e)	Totali i kapitalit rregullator

Tabela 3
Mjaftueshmëria e kapitalit
(Rregullorja për “Raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”)

Informacion cilësor	a)	Modeli i vlerësimit të bankës për mjaftueshmërinë e kapitalit (nëse ekziston një e tillë përndryshe metoda e përcaktuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë);
Informacion sasior	b)	Kërkesa për kapital për mbulimin e rrezikut të kredisë: - aktivet e ponderuara me rrezikun (formulari 12); - zërat jashtë bilancit që përfaqësojnë kontrata të instrumenteve financiare mbi normat e interesit dhe kurset e këmbimit, të ponderuara me rrezikun (formulari 13); - zëra të tjerë jashtë bilancit (formulari 14).
	c)	Kërkesa për kapital për mbulimin e rreziqeve të tregut, të lidhura me normat e interesit dhe kursin e këmbimit (VF – formulari 39).
	d)	Kërkesa për kapital për mbulimin e rrezikut operacional (modeli i vlerësimit nëse ekziston).
	e)	1. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (formulari 15). 2. Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit (formulari 15).

B. Ekspozimet ndaj rreziqeve dhe vlerësimi i tyre

Tabela 4
Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm
(Rregullorja për “Administrimin e rrezikut të kredisë”)
(çdo tremujor)

Informacion cilësor	a)	Kërkesa për informacion të përgjithshëm që lidhet me rrezikun e kredisë sipas kërkesave të rregullores, që përfshin: - përkufizimin e kredive me probleme (rregullorja për “Administrimin e rrezikut të kredisë”); - përshkrimin e metodës së përdorur për provigjonet statistikore dhe për humbjet nga kreditë (nëse ka banka një të tillë, përndryshe rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”); - politikën e bankës për administrimin e rrezikut të kredisë; - përshkrimin e natyrës së ekspozimit brenda çdo portofoli (sipas metodës së bankës nëse ka një të tillë) dhe planet e afatet kohore të drejtimit të bankës, për zbatimin e kësaj metode.
Informacion sasior	b)	Teprica bruto e kredisë, teprica mesatare bruto e kredisë gjatë periudhës tremujore, sipas llojeve kryesore të ekspozimeve të kredisë.
	c)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas shpërndarjes gjeografike.
	d)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas industrisë ose tipit të kundërpartisë.
	e)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas maturitetit të mbetur (kontraktual).
	f)	Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (d), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
	g)	Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (c), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
	h)	Fondet për provigjone dhe lëvizjet gjatë periudhës (shtesa +, pakësime -).

Tabela 5
Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm
(Rregullorja “Mbi rreziqet e tregut”)
(çdo gjashtëmujor)

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm cilësor, për rreziqet e tregut sipas kërkesave të rregullores.
Informacion sasior	b)	Kërkesa për kapital për: - rrezikun nga normat e interesit; - rrezikun nga kursi i këmbimit.

Tabela 6
Rreziku operacional

(çdo tremujor)

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm për metodën e përdorur në vlerësimin e rrezikut operacional (nëse ekziston).
Informacion sasior	b)	Kërkesa për kapital për rrezikun operacional.

Tabela 7
Rreziku i likuiditetit
(çdo tremujor)

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm sipas kërkesave të rregullores
Informacion sasior	b)	- Niveli i aktiveve likuide dhe burimeve e përdorimeve të fondeve të bankave. - Niveli i aktiv-pasiveve afatshkurtra. - Niveli i burimeve të fondeve nga të tretët sipas maturitetit të mbetur. - Një pasqyrë e fluksit të rrjedhjes së parave (<i>cash flow-t</i>). - Vlera e aktiveve të titullzuara (nëse ka) etj.

C. Tregues të ekspozimit të degës së bankës së huaj ndaj rreziqeve

Tabela 8
Depozita ekuivalente e kapitalit
(çdo muaj)

Nr.	Depozita ekuivalente e kapitalit (DEK-a):	Shuma
1.	Depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre.	
2.	Bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.	
3.	Letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.	
	SHUMA	

Tabela 9

Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut
(çdo tremujor)

Kodi	Treguesit (në mijë lekë)	
1	Totali i aktiveve në fund të tremujorit paraardhës	
2	Teprica e kredisë e tremujorit raportues	
3	Raporti tepricë kredie / total i aktiveve (në %) (2:1 x100)	
4	Kufiri maksimal i rrezikut	70%

VENDIM
Nr.61, datë 29. 08.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, të nenit 12 shkronja “a”, të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 57 pika 2, nenit 58, nenit 59 pikat 2 dhe 3, nenit 60 dhe nenit 61, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me vendimin nr.52, datë 14.7.2004 dhe ndryshuar me vendimin nr.101, datë 27.12.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas nenit 3, shtohet neni 4 me titullin “Përkufizime” dhe me përmbajtje si vijon:

1. Termat e përdorur në këtë rregullore, kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

“Kredimarrës i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit” është kredimarrësi që përfiton kredi në valutë (monedhë të huaj) dhe/ose të indeksuar në valutë (monedhë të huaj) nga banka, dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ardhurat e tij në origjinë gjenerohen në monedhë vendase ose në një monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë;

b) të ardhurat e tij në valutë (monedhë të huaj) mbulojnë më pak se 80% (tetëdhjetë për qind) të kështit të kredisë ose të kredisë në total (kryegjë dhe interes, në varësi të periudhës së llogaritjes) dhe detyrimeve të tjera në monedhë të huaj ose të indeksuara në valutë.

b) Në nenin 7, paragrafi 7.1 në shkronjën a, pas presjes shtohet fraza e mëposhtme:

“.. si dhe struktura (funksione) të veçanta për administrimin e rrezikut dhe analizën ekonomike të tij”.

c) Në nenin 7, paragrafi 7.4 shtohen shkronjat “c” dhe “d” me përmbajtje si vijon:

c) Banka, në varësi të llojit të kredisë dhe rrezikut të saj, miraton dhe zbaton politika dhe akte të tjera të brendshme, lidhur me kërkesat e kolateralit dhe/ose garancive, në të cilat përcaktohet minimalisht lloji i garancisë dhe raporti i kolateralit me vlerën e kredisë (përfshirë kryegjëja dhe interesi). Aktet e brendshme do të përshkruajnë edhe rastet kur nuk do të kërkohej kolateral/garanci.

d) Banka, për të siguruar kredinë, duhet të kërkojë dhe të sigurohet për vendosjen e një kolaterali dhe/ose garancie, siç është përcaktuar në aktet e brendshme të saj. Rastet e përjashtimeve nga ky rregull duhet të përshkruhen në aktet e saj të brendshme. Në rastet kur kërkohej dhe vendoset kolaterali dhe/ose garancia, banka merr të gjitha masat e nevojshme për mbajtjen të mjaftueshme të vlerës së tij, gjatë gjithë jetës së kredisë.

c) Në nenin 7, shtohet paragrafi 7.5 me përmbajtjen si vijon:

7.5 Këshilli drejtues, në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në vit:

a) rishikon strategjitë, politikat dhe aktet e brendshme të bankës për aktivitetin kredidhënës dhe administrimin e rrezikut të kredisë, në përputhje me ndryshimet e kushteve të tregut dhe me rregullat e mbikëqyrjes;

b) analizon dhe vlerëson veçanërisht zbatimin e strategjive, politikave dhe akteve të brendshme të bankës për aktivitetin kredidhënës dhe administrimin e rrezikut të tij, duke përfshirë këtu dhe rreziqet nga dhënia e kredive në valutë (monedhë të huaj) dhe/ose të indeksuar në valutë (monedhë të huaj).

d) Në nenin 17, pas togfjalëshit “Këshilli drejtues i bankës” shtohet fraza si vijon:

“...dhe/ose kur, mbështetur në analizat e tyre, gjykojnë se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.”

e) Në nenin 22/2, shtohen paragrafët 2/1, 2/2 dhe 2/3, me përmbajtjen si vijon:

2/1. Banka ponderon me koeficientin e rrezikut 100% (një qind për qind), për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerën e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë për kredimarrësin, që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4, pika 2, të kësaj rregulloreje dhe karakteristikat e përcaktuara në pikën 8.1.3, shkronja “a”, të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së

kapitalit”.

2/2. Banka ponderon me koeficientin e rrezikut 150% (një qind e pesëdhjetë për qind) për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerën e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë për kredimarrësin që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4 pika 2 të kësaj rregulloreje dhe karakteristikat e përcaktuara në pikën 8.1.4 shkronja “f” të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

2/3. Totali i kredive në valutë dhe/ose të indeksuara në valutë të bankës për kredimarrësit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, nuk duhet të kalojë 400 për qind të kapitalit rregullator të saj në baza individuale dhe të konsoliduara. Çdo shumë që tejkalon këtë kufi do të zbritet nga kapitali rregullator i bankës për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

f) Në nenin 22/3, shtohet paragrafi 7 me përmbajtjen si vijon:

7. Kërkesat e kësaj rregulloreje, sipas nenit 22/2, paragrafët 2/1, 2/2 dhe 2/3, do të zbatohen nga subjektet për:

a) kreditë që do të jepen për “Kredimarrësit e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit” nga fillimi i muajit shtator i vitit 2008 dhe në vazhdim;

b) kreditë ekzistuese për “Kredimarrësit e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit” që do të ristrukturohen nga muaji shtator i vitit 2008 dhe në vazhdim.

g) Nenet 4, 5, 6, 7 dhe në vijim rinumërohen përkatësisht si neni 5, 6, 7, 8 etj.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Statistikave për të përgatitur dhe propozuar në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha ndryshimet e nevojshme në formularët e raportimit (SRU), që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.62, datë 29.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të nenit 57, pika 2, nenit 58, nenit 59 pikat 2 dhe 3, nenit 60 dhe nenit 61, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja”, miratuar me vendimin nr.57, datë 15.10.2007 të Këshillit Mbikëqyrës, të Bankës së Shqipërisë bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 11, paragrafi 1, shprehja...njëkohësisht...” zëvendësohet me shprehjen “..të paktën një nga...”;

b) Në nenin 11, paragrafi 1, shkronja “a”, bëhet:

“...vlera mesatare e aktiveve të saj, për 2(dy) tremujorë rradhazi, nuk duhet të tejkalojë 6.25 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar”;

c) Në nenin 11, paragrafi 1, shkronja “b”, bëhet:

“vlera mesatare e depozitave të saj, për 2(dy) tremujorë rradhazi nuk duhet të tejkalojë 6.25 për qind të totalit të depozitave të sistemit bankar.”.

d) Në nenin 13, paragrafi 1, bëhet si më poshtë:

“... Në zbatim të kërkesave dhe detyrimeve të kësaj rregulloreje, dega raporton në Bankën e Shqipërisë respektivisht çdo muaj sipas formularit nr.1 dhe çdo tre muaj sipas formularit nr.2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.100, datë 26.8.2008

PËR MIRATIMIN E KODIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 55 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” pika 7, si dhe shtojca E, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.53, datë 23.5.2008 “Për fillimin e procedurave për disa ndryshime në kodin e funksionimit, të shpërndarjes së energjisë elektrike, kodin e sistemit të transmetimit, dhe kodin e matjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.8.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi draftin e kodit të shpërndarjes së energjisë elektrike të përgatitur nga ana e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

(Kodi bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Shfuqizimin e vendimit nr.39, datë 30.8.2005 “Për miratimin e kodit të funksionimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepavishta

VENDIM
Nr.101, datë 26.8.2008

PËR MIRATIMIN E KODIT TË MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 55 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2007 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” pika 7, si dhe shtojca E, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.53, datë 23.5.2008 “Për fillimin e procedurave për disa ndryshime në kodin e funksionimit, të shpërndarjes së energjisë elektrike, kodin e sistemit të transmetimit, dhe kodin e matjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.8.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi draftin e kodit të matjes së energjisë elektrike të përgatitur nga ana e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit të matjes së energjisë elektrike.
(Kodi bashkëlidhur këtij vendimi).
 2. Shfuqizimin e vendimit nr.18, datë 29.3.2005 “Për miratimin e kodit të matjes së energjisë elektrike”.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.103, datë 4.9.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa “g”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007 Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.9.2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për hartimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.104, datë 4.9.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES PËR
PROCEDURAT E LICENCIMIT

Në mbështetje të neneve 9 dhe 14 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e

energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa “g”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.9.2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit në aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepavishta

VENDIM
Nr.105, datë 4.9.2008

PËR NJË DEVIJIM NGA RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S
NË LIDHJE ME PROCESIN E RISHIKIMIT TË RREGULLORES PËR PROCEDURAT E
LICENCIMIT

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 38 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.9.2008, pasi vendosi të fillojë procedurat për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit,

duke konstatuar,

- nevojën për plotësimin në një kohë të shkurtër të kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike si pjesë e rëndësishme e procesit të privatizimit të OSSH sh.a.,

VENDOSI:

1. Të kryejë një devijim nga neni 26 i rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s në lidhje me afatin e botimit të njoftimit dhe të marrjes së komenteve nga palët e interesuara mbi draftin e rregullores për procedurat e licencimit.

2. Afati i botimit të njoftimit në gazetë bëhet 2 ditë dhe afati i pritjes së komenteve për rregulloren e procedurave të licencimit është deri më datë 8.9.2008.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për ndjekjen e procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepavishta

VENDIM
Nr.106, datë 4.9.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR FURNIZIMIN
ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK
ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSSH SHA (FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR
PERIUDHËN 1.7.2008 DERI MË 31.12.2008

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “f”, paragrafi 5, të modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, pikës V.1, të rregullave të tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, datë 23.6.2008, nenit 18, pika 1, germa “c”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.9.2008, pasi diskutoi mbi draftin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (Furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (Furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.7.2008 deri me 31.12.2008”, konstatoi se:

- kontrata është lidhur nga KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. subjekte të licencuara nga ERE, përkatësisht me vendimet nr.9, datë 25.1.2008 dhe nr.11, datë 23.6.2006, të ndryshuar;
 - modeli i tregut të energjisë elektrike dhe Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike përcaktojnë se kjo kontratë i nënshtrohet tregut të rregulluar;
 - në referencë të akteve të sipërcituara, ERE është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj kontrate,
- për sa më sipër evidentuar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.7.2008 deri më 31.12.2008.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepavishta

VENDIM

Nr.108, datë 9.9.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT, NDRYSHIMIT, TRANSFERIMIT TË PLOTË /TË PJESSHËM DHE RINOVIMIT TË LICENCEVE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 14 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 21, të rregullores së procedurave të licencimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2008, pasi u njoh me draftin final të rregullores për procedurat e licencimit përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, ndryshimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licence (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores se procedurave të licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Ndreqje gabimi

Në Fletoren 128, datë 4.8.2008, në vendimin nr.1047, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, në faqen 4, pika 6, paragrafi i parë dhe i dytë, bëhet korrigjimi, ku vendosen shkronjat “a” dhe “b”, si më poshtë vijon:

Ishte:

6. Pas pikës 6 të kreut IV, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëritë, që kanë kryer sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktojnë palëve të treta, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, duhet që brenda këtij afati, të paraqesin dokumentin përkatës në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin. Shoqëria nuk do ta ushtrojë veprimtarinë deri në çastin e paraqitjes së këtij dokumenti në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin.”.

Bëhet:

Paragrafi i parë:

“7. a) Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizimi, brenda 30 ditëve...”.

Paragrafi i dytë:

“b) Shoqëritë, që kanë kryer sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet ...”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.9.2008
Doli nga shtypi më 16.9.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë